

## KOMPENSIMI REGIONAL PËR MOBILITA' - LIGJI REGIONAL 27.11.1993, N. 19 – SHËNIM INFORMATIV -

Kompensimi regional për mobilità në bazë të L.R. 19/1993 e ss.mm. është parashikuar për punëtorët e pa punë të rregjistruar në listat për mobilità të Provincës Autonome Trento o të Provincës Autonome Bolzano, të cilët plotësojnë kushtet në bazë të nenit .1 të këtij ligji .

### *Fillimi e kohëzgjatja*

Kompensimi fillon një ditë më pas nga pushimi nga puna për 12 muaj maksimumi, edhe pse nuk janë në vazhdim në rast pezullimi nga lista për mobilità (punë me kohë të caktuar – të pacaktuar part-time – leje lindje).

### *Përcaktimi i shumës*

Kompensimi regional për mobilità është në masën 80% të pagës së punës para rregjistrimit në listë, me 840,81 euro mujore maksimumi. Nga kjo shumë zbriten, deri sa të grumbullohen , trajtimi për papunësi të zakonshme i tërhequr nga Inps. Në vazhdim n.q.se një punëtor ka një pagesë ditore të lartë e kështu një papunësi të zakonshme mujore superiore me limitet e caktuara, për këtë muaj nuk merr asnjë shumë si kompensim regional: sidoqoftë kjo periudhë llogaritet në fund të 12 mujve të përcaktuara për kompensim.

### *Pagesa e parë*

Pagesa e parë nuk bëhet para plotësimit të 90 ditëve papunësie, të cilat mund të llogariten edhe pse nuk janë në mënyrë të vazhdueshme. Në vazhdim aprovohet, me vendimin e drejtuesit, dhënia e kompensimit regional e cila i komunikohet edhe të interesuarit.

### *Pagesat e mëpastajshme*

Pagesat e mëpastajshme bëhen mujore me plotësimin nga ana e punëtorit të formularit C) "dichiarazione mensile" pranë il Centro per l'impiego kompetente per territorin, i cili duhet të prezantohet brënda ditës së 30të të muajit pasues nga ai i referuar, e kushtëzuar gjithmone nga vendndodhja në listën për mobilità gjatë periudhës së papunësisë.

Në rast pezullimi nga lista për mobilità per punë me kohë të caktuar kompensimi likuidohet deri në ditën para marrjes në punë. Me shkëputjen e mardhënieve nga puna punëtori ka të drejtë të marrë kompensimin regional të mbetur deri në plotësimin e 12 muajve,zbritur shuma për papunësi të zakonshme që i përket. Për këtë qëllim punëtori duhet të plotësojë formularin C) duke shënuar nëse ka prezantuar kërkesë të re për papunësi të zakonshme pranë Inps.

### *Sektori i ndërtimit*

Për punëtorët në sektorin e ndërtimit preçizohet që, në periudhën në të cilën trajtohen për papunësi edile nga Inps, nuk jepet kompensimi regional për mobilità sepse dy trajtimet janë të papajtueshëm. Në këtë rast punëtorët e shkruar në listën për mobilità kanë të drejtë nëntë muaj kompensim regional e jo dymbëdhjetë.

### *Leje lindje*

Gjatë periudhës së lejes së lindjes me rrezik e të shkëputjes së detyruar nga puna (dy muaj para datës së lindjes e tre muaj pas lindjes) punëtorja pezullohet nga lista për mobilità e si rrjedhim ndërpreritet edhe kompensimi regional për mobilità.

Mbas lindjes punëtorja duhet të komunikojë datën e lindjes së fëmijës.

Me të mbaruar periudha e shkëputjes së detyruar, punëtorja, me kërkesë të posaçme me shkrim, mund të kërkojë një periudhë tjetër pezullimi nga lista për mobilità deri në 6 muaj maksimumi që mund të jenë edhe me ndërprerje. Pezullimi nga lista do të sjellë pezullimin e dhënies së kompensimit regional për mobilità.

**N.B.:** *ju kujtojmë se dërgimi në kohë i formularve është kusht i domosdoshëm për dhënien e pagimit e kompensimit regional për mobilità. Në mungesë të plotësisht të tyre nga ana e punëtorit mbas një kërkesë me shkrim parashikohet arkivimi i kërkesës ose heqja e të drejtës për kompensim.*